



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2362 / Prot.
11

Tiranë, më 28. 8. 2020

URDHËR

Nr. 272, Datë 28. 8. 2020

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NGA
“MASTER I SHKENCAVE” NË “E DREJTË NDËRKOMBËTARE DHE TREGTARE”
NË “MASTER I SHKENCAVE” NË “E DREJTË NDËRKOMBËTARE TREGTARE” NË
UNIVERSITETIN E NEW YORK-UT, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë nga “Master i Shkencave” në “E Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare”, me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike (4 semestra), në “Master i Shkencave”, në “E Drejtë Ndërkombëtare Tregtare”, me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike (4 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.

Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master i Shkencave”, në “E Drejtë Ndërkombëtare Tregtare”, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, në “E Drejtë Ndërkombëtare Tregtare”, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, fillon në vitin akademik 2020-2021.
3. Universiteti i New York-ut Tiranë të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm, lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të studimit të tregut të punës, duke ofruar të dhëna që lidhen drejtpërdrejt me programin e studimit, përmirësimi i literaturës së detyrueshme të 5 (pesë) viteve të fundit për programet e lëndës (syllabuset), angazhimi i personelit akademik që kanë formim akademik profesional që lidhen me fushë e programit të studimit, përpara fillimit të veprimtarisë akademike të programit të studimit.
4. Universiteti i New York-ut, Tiranë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Universiteti i New York-ut, Tiranë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut, Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI

